



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË
Kosovska Agencija za Forenziku | Kosovo Agency on Forensic

BROSHURË INFORMATIVE

Prishtinë

2017



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË
Kosovska Agencija za Forenziku | Kosovo Agency on Forensic

OBJEKTIVAT DHE VIZIONI I AKF-SË

Zhvillim i teknologjisë dhe shkencës ka bërë të mundur futjen e metodave shkencore në hetimin dhe zbulimin e krimit, si ndihmë me rëndësi vendimtare, duke i ofruar sistemit gjyqësor konkluzione të bazuara në të dhëna shkencore.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ka arritur të përbush të gjitha objektivat dhe detyrat e parapara sipas mandatit ligjorë. Rritja e



Dr.sc. Blerim Olluri –Kryeshef ekzekutiv

numrit të ekspertimeve forenzike është treguesi më i mirë i punës dhe performancës së lartë të AKF-së, duke ditur se të gjitha këto ekspertime janë kryer me një cilësi dhe kontroll të lartë dhe të dokumentuar.

Gjatë vitit 2016 kemi aprovuar strategjinë zhvillimore për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë për vitet 2016-2020. Ne sot kemi (5) pesë divizione (laboratorë) të akredituara sipas e standardeve SK EN ISO/IEC 17025.

Krahas zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve forenzike Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka vazhduar me ndërtimin e aneks objektit dhe planifikojmë që këtë viti të behet funksionalizimi i plotë i tij duke krijuar kështu kushte dhe hapësirë mjaftueshme lidhur me kërkesat dhe nevojat e Laboratorëve të AKF-së për kryerjen e ekspertizave.

Duke ndjekur këtë vijë të rrugëtimit, dëshiroj të siguroj publikun se Agjencia e Kosovës për Forenzikë po ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të arritur dhe mbajtur nivelin më të lart profesional në ofrimin e shërbimeve forenzike.

MISIONI

Misioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së saj, të ofroj shërbime forenzike cilësore në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm, objektivë e profesional të ekspertizave shkencore forenzike. Agjencia e Kosovës për Forenzikë i kryen veprimet e saj me urdhër të gjykatës, prokurorisë apo me kërkesë të agjencive të zbatimit të ligjit.

Veprimtaria dhe Organizimi

- AKF kryen ekspertime të dëshmive, sipas kodit të procedurës penale dhe legjislacionit në fuqi.
- AKF dëshmon në gjykatë apo prokurori ashtu siç është paraparë në Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionit në fuqi.
- AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale del në vend të ngjarjes për asistencë në shikimin e vendit të ngjarjes.
- AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale do të asistoj në rikonstruimin e vendit të ngjarjes.
- AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale do të asistoj në rikonstruimin e vendit të ngjarjes. (neni 18, ligji nr. 04/L-064).


Llojet e ekspertizave

- Dëshmime në gjykatë në cilësinë e ekspertit
- Asistencë në shikimin dhe rikonstrukcionin e vendit të ngjarjes për krime të rënda
- Informata operative njësisive hetimore
- Ekspertizë balistike (armët e zjarrit dhe municion)
- Ekspertizë të dokumenteve
- Ekspertizë grafologjike të nënshkrimeve dhe të dorëshkrimeve
- Ekspertizë të substancave narkotike
- Ekspertizë të numrave identifikues të automjeteve
- Ekzaminim të gjurmës së veglës, këpucës dhe gomava të automjetit
- Ekspertizë daktiloskopike (ekspertiza e gjurmëve të gishtërinjve)
- Analizë të AND-së
- Ekzaminim të kompjuterëve dhe të telefonave celularë
- Ekzaminim të zërit
- Ekzaminimi i eksplozivëve
- Procesim, përgatitje dhe dërgim-pranim të dëshmive për ekspertizë jashtë vendit
- Koordinim dhe bashkëpunim me laboratorë vendore dhe ndërkombëtare

Agjencia e Kosovës për Forenzikë është e organizuar në konceptin piramidal të hierarkisë dhe funksionimit në nivel të menaxhmentit ekzekutiv, departamentit dhe Laboratorit (divizionit) si në vijim:

- Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv;
- Departamentet;
- Laboraret (divizionet);
- Njesitë.

Numri i përgjithshëm i personelit të AKF-së është pesëdhjetë e dy (52).



Organogrami i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë

AKREDITIMI I METODAVE TË DIVIZIONEVE / LABORATORËVE TË AGJENCISË SË KOSOVËS PËR FORENZIKE SIPAS STANDARDIT NDËRKOMBËTAR

SK EN ISO/IEC 17025.



Nga viti 2015 Agjencia Kosovës për Forenzikë ka të akredituara 5 divizione (laboratorë) dhe në vazhden e procesit të akreditimit¹ të metodave forenzike do të vazhdoj edhe më tutje konform legjislacionit në fuqi zgjerimin e procesit të akreditimit të metodave forenzike edhe për divizionet/laboratorët tjerë të AKF-së. Realizimi i këtij objektivi do të ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga AKF-ja drejt mekanizmave tjerë të zbatimit të ligjit, dhe veçmas do të ndikoj në rritjen e profesionalizmit të personelit të saj. Divizionet-laboratorët e AKF-se që janë të akredituara nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës janë:

- Divizionin (Laboratorin) për Analiza Serologjike dhe ADN-së.
- Divizionin (Laboratorin) për Analiza Kimike të Narkotikëve.
- Divizionin (Laboratorin) e Balistikës.
- Divizionin (Laboratorin) e Daktiloskopisë & Traseologjisë.
- Divizionin (Laboratorin) për Dokumente dhe Dorëshkrime.



SK EN ISO/IEC 17025
LT / 046 / 2015 / DAK

¹ "Akreditim" nënkupton procedurën e njohjes zyrtare, të kompetencës së një organi për vlerësimin e konformitetit në përputhje me standardet dhe me rregullat teknike për të kryer detyra, si: testim, kalibrim, certifikim ose inspektim;


SISTEMET E BAZAVE TË TË DHËNAVE NACIONALIA PËR IDENTIFIKIM

AFIS

Sistemi Automatik i Identifikimit të gjurmëve të gishterinjve

CODIS

Sistemi i kombinuar i profileve të ADN-së



Sistemi i Integruar i Identifikimit Balistik

IBIS


Sistemi AFIS: Identifikimi automatik i gjurmëve të gishtërinjve është proces i krahasimit automatik të një apo më shumë shenjave të gishtërinjve (gjurmëve) të panjohura kundër një baze të dhënash të njohura dhe gjurmëve të panjohura me një algoritëm specifik. Serveri kryesor i AFIS-it që gjendet në AKF në Prishtinë.

Në objektin e AKF-së në Prishtinë është i vendosur stacioni qendror me pesë nënstacione, nga një nënstacion në rajonet policore dhe pesë stacione kontrolluese kufitare LiveID nëpër kufijtë e Republikës së Kosovës. Sistemi AFIS gjithashtu është i ndërlidhur edhe me sistemin kufitar BMC (border management control).

Sistemi AFIS poashtu shtrihet në pesë stacione

kufitare të sistemit të LiveID-së, me të cilin sistem bëhet kontrollimi i biografisë kriminale (criminal background check) dhe tri prej tyre gjenden në pika kufitare, një në Aeroportin e Prishtinës dhe një në AKF.

SHBA këtë vit do të bëjë përditësimin e sistemit me rreth 1 mil dollar.



Sistemi CODIS: Në fund të prillit 2013 është instaluar baza e të dhënave të ADN-së (versionin më të ri të

softuer-it, përkatësisht versionin 7.0). Ky sistem


është donacion i Qeverisë Amerikane, gjegjësisht FBI, realizuar nga marrëveshja midis FBI-së dhe MPB-së.

Në CODIS regjistrohen dhe ruhen në vazhdimësi një numër i konsiderueshëm i profileve të ADN-së, të kategorive të ndryshme si profile të panjohura nga vendi i ngjarjes, profile të personave të zhdukur dhe të familjarëve të tyre, profile të personave të dyshuar etj.

Me urdhëresë të gjykatës, të prokurorisë apo të institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit, bëhen kërkime për krahasime të profileve të ADN-së, në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Në proces e sipër është edhe hartimi i legjislacionit për databazat

elektronike me të dhënat forenzike të personave dhe armëve me qëllim të zbulimit dhe identifikimit të kryerësve të veprave penale.



Sistemi IBIS: *Sistemi i Integruar për Identifikim Balistik është donacion nga Komisioni Evropian në vitin 2010. Vlera e donacionit të dhënë nga ky komision është 1.089.512,00 €. Sistemi përbëhet nga shtatë pjesë kryesore dhe shërben për të marrë kopje digjitale të karakteristikave individuale balistike, nga gëzhojat apo nga plumbat e shkrepur nga arma e zjarrit, ruajtjen e tyre në server për kohë të pacaktuar, krahasimin automatik të tyre dhe dhënien e rezultateve të kërkimit në mënyrë kompjuterike për verifikim dhe validim nga eksperti i balistikës.*



IBIS përbëhet nga:

- *Dy njësi për marrjen e kopjeve digjitale të karakteristikave individuale nga gëzhojat,*
- *Një njësi për marrjen e kopjeve digjitale të karakteristikave individuale nga predhat,*
- *Serveri për krahasimin dhe ruajtjen e të dhënave,*
- *Njësia për përqendrimin e të dhënave dhe*
- *Dy njësi për verifikimin dhe validimin e rezultateve të kërkimit automatik.*

SHERBIMET

Agjencia e Kosovës për Forenzikë kryen këto ekspertiza forenzike me Metoda të akredituara sipas standardit ndërkombëtar SK EN ISO/IEC 17025.



Eksperti i ADN-së gjatë procesimit të dëshmive



Ekspertja e Narkotikëve gjatë procesit të analizës

Analizat/ Analizat/ ekspertizat që kryhet me Metoda të akredituara²

Divizioni (Laboratori) për Analiza kimike të Narkotikëve

Analiza e substancave të dyshimta si narkotik me Kromatografi në shtresë të hollë (TLC)

Analiza me Testin Duquenois - Levine i modifikuar

Testi i ngjyrës – Marquis

Testi i ngjyrës - Tiocianati i Kobaltit

Testi i ngjyrës - Sodium Nitroprusside

Testi i ngjyrës -Ekzaminimi i Bates-it

Testi i ngjyrës – Reagenti i Libermanit

Analiza e substancave të dyshimta me Kromatograf të gazrave - analizimet me detektorin e flakës së jonizuar; Gas Kromatograf, Agilent FID

Analiza e substancave të dyshimta me Kromatograf të gazrave / Spektrometer të masës (GC/MS) – metoda e përgjithshme për analizimin e drogave; Gas Kromatograf, Agilent 6890 N dhe Detektori i Masës: 5973 Inert

² **Metoda të akredituara** – janë metodat valide shkencore të cilat i janë nënshtruar procedurës së njohjes zyrtare, të kompetencës nga një organ vlerësues të konformitetit të tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me rregullat teknike që parashohin këto metoda.

Divizioni (Laboratori) i ADN-së/Serologjisë

Testi KM (ang. Kastle Meyer Test), si test preliminar për identifikimin e gjakut

Analizat e ADN-së nga qimet dhe indet

Analizat e ADN-së nga eshtrat dhe dhëmbët

Divizioni (laboratori) i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë

Ekzaminimi i vijave papilare duke ndjekur metodën AKV-V (Analizë, Krahasim, Vlerësim dhe Verifikim)

Ekzaminimi me metoda fizike për nxitjen e vijave papilare – pluhurat instant, pluhura të veçanta (speciale), pluhuri magnetik, dhe pluhurat fluorescent

Ekzaminimi me metoda kimike për nxitjen e vijave papilare – Cyanoacrylat, Acid Yellov, Ninhydrin, DFO, SPR, Amido Black, Zhvillues Fizik, Sticky Side Powder, Gentian violet, Pluhuri i zi alternativ

Ekzaminimi fizik dhe klasifikimi i gjurmëve të veglave, këpucëve dhe gomave

Divizioni (Laboratori) i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve

Ekspertimi i dokumenteve sigurorese

Aplikimi i lumineshencës në ekspertimin e dokumenteve

Absorbim/reflektimi me rrezet infra të kuqe (IK) në ekzaminimin e dokumenteve

Ekspertimi dhe krahasimi i dorëshkrimeve komponentëve të tyre

Ekspertimi dhe krahasimi i nënshkrimeve

Ekspertimi i ndërhyrjeve/modifikimi

Kontrollimi i gjurmës së thelluar

Ekspertimi i makinave të shkrimit

Ekspertimi i stampave dhe gjurmëve të tyre

Ekspertimi i teknikave të printimit

Ekspertimi jo destruktiv i letrës

Divizioni (Laboratori) i Balistikës

Ekzaminimi fizik, klasifikimi dhe identifikimi i armëve të zjarrit dhe pjesëve të tyre

Ekzaminimi fizik, klasifikimi dhe identifikimi i predhave (plumbave)

Ekzaminimi fizik, klasifikimi dhe identifikimi i gëzhjojave dhe fishekëve

Ekzaminimi fizik, klasifikimi dhe identifikimin e gëzhjojave të municionit të gjuetisë dhe komponentëve të tyre

Përveç metodave të akredituara Agjencia e Kosovës për Forenzikë kryen edhe këto ekspertiza forenzike me metoda të cilat janë në pritje për tu akredituar.



Ekspertet e ADN-së gjatë procesit të punës

Analizat/ ekspertizat që kryhet me Metoda në pritje për tu akredituar ³

Divizioni (Laboratori) i Balistikës

Ekzaminimi i Numrave Identifikues të Automjeteve

Rikonstruimi e të shtënave më armë zjarri

Divizioni (Laboratori) i ADN-së/Serologjisë

Testi AP (ang. Acid Phosphatase test), si test preliminar për identifikimin e spermës

Ekzaminimi mikroskopik për spermatozoid, si test konfirmues për identifikimin e spermatozoideve (punimi i sllajdeve mikroskopike dhe vrojtimi për identifikim të spermatozoideve me mikroskop)

Testi PSA (ang. Prostatic specifik antigjen test), si test preliminar për identifikimin e spermës

Testi - RSID BLOOD-test konfirmues për gjak

Analizat e ADN-së nga gjaku

Analizat e ADN-së nga pështyma

Analizat e ADN-së nga sperma

Analizat e ADN-së nga prekja apo kontakti (djersa dhe qelizat epiteliale)

³ **Metoda në pritje për tu akredituar**- Janë metoda valide shkencore të cilat janë të pranueshme në gjykatë apo Prokurori por për arsye të mungesës së buxhetit nuk janë akredituar ende.

Divizioni (Laboratori) për analiza te eksplozivëve, zjarrvënjeve dhe grimcave të barotit

Analiza për identifikimin e Nitroglicerines (NG) dhe Nitrocelulozës (NC) në Barotin (lëndën djegëse shtytëse) pas gjuajtjes me armë zjarri.

Analiza për identifikimin e Nitriteve dhe Nitrateve në Barotin (lëndën djegëse shtytëse) pas gjuajtjes me armë zjarri.

Analiza për identifikimin e eksplozivëve organik (TNT, RDX, HMX, TETRYL, NG dhe PETN) para dhe pas shperthimit.

Divizioni për ekzaminim të kompjuterëve

Ekzaminimi i kompjuterëve

Ekzaminimi i SIM kartelave

Ekzaminimi I te gjitha llojeve të USB-ve

Ekzaminimi I te gjitha llojeve të CD/DVD

Ekzaminimi I te gjitha llojev te Memory -kartelave

Krijimi i imazhit te medimeve elektronike (kopjimi fizik i mediumit)

Divizioni i Imazhit digjital, Videos dhe Audios

Ekzaminimi i fotografisë.

Ekzaminimi i videos

Ekzaminimi i zërit


Analiza për identifikimin e Folësit

STATISTIKA TË DËSHMIVE TË EKSPERTUARA

GJATË VITËVE 2012-2016

Agjencia e Kosovës për Forezikë çdo vit pothuajse arrin që të ekspertoj me sukses rreth 4000-5000 ekspertiza / raste me mbi 40,000 dëshmi të ndryshme të implikuara në vepra penale të ndryshme.

Të gjitha këto dëshmi procedohen në mënyrë profesionale dhe kalojnë neper procesin e menaxhimit të kontrollit sipas standardit ndërkombëtar SK EN ISO/IEC 17025.



Grafiku1: Numri i dëshmive të ekspertuara gjatë viteve 2012-2016.

NGRITJA E KAPACITETEVE, BASHKEPUNIMI RAJONAL DHE ANETARËSIMI NË ORGANIZATA NDERKOMBETARE FORENZIKE I AKF-SË

Për shkak të kompleksitetit të formave të krimit dhe trendëve globale është shumë e rëndësishme që AKF-ja si njëra nga shtyllat që merren me parandalimin formave të ndryshme të krimit përmes ekspertimeve forenzike të kenë mjetet teknike dhe teknologjinë bashkëkohore dhe të standardizuara, hapësirën adekuate për kryerjen e ekspertimeve forenzike dhe burimet njerëzore të nivelit të lartë dhe profesional me qëllim të ngritjes së kapaciteteve forenzike të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

Për të realizuar këtë Agjencia e Kosovës për Forenzikë do të angazhohet për plotësimin dhe përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese si dhe ngritjen dhe zgjerimin e fushave të reja të ekspertizës (zhvillimi i procedurave reja dhe validimi i metodave të reja shkencore) të cilat për momentin nuk kryhen në Divizionet e AKF-së siç janë: shumica e eksploziveve organik, eksplozivet inorganik, zjarre vëniat, grimcat e barotit nga kapsolla (GSR), materialet piroteknike, validimi i metodave dhe kemikateve të reja për ekstahimin dhe analizimin e ADN-së , ekspertimi i shurdhuesve, përcaktimi i distancës së qitjes me metoda kimike, etj, me qëllim të përmbushjes dhe realizimit të gjitha fushave të ekspertizës forenzike për përgjigjen në kërkesat e Gjykatave, Prokurorive dhe Agjencive zbatuese të ligjit në Republikën e Kosovës dhe të arrihet niveli i cilësisë për të qenë konkurrues në rajon dhe me gjerë sipas standardit ndërkombëtar për cilësi ISO 17025.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë krahas bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar ka të nënshkruar Memorandum bashkëpunimi me FBI-në(Federal Byro of Investigation) në fushën e forenzikes, poashtu jemi në prag të nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit në fushën e forenzikes edhe me Policinë shkencore të Shqipërisë. Ndërsa kemi filluar edhe bashkëpunimin me të gjerë rajonal me institutet homologe forenzike ku si rezultat i këtij bashkëpunimi presim që shumë shpejt edhe nënshkrimin e Memorandumit të bashkëpunimit me institutin e Kroacisë "Ivan Vuçetiç".

Aktualisht Agjencia e Kosovës për Forenzikë është e anëtarësuar në ENFSI (European Network Forensic Science Institute) si anëtare shoqëruese në grupet punese përkatëse forenzike të kësaj organizate ndërsa synimi i AKF-së është që sa më parë të jemi edhe anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë pra ENFSI. Kjo do të mundësonte që Divizionet/Laboratorët e AKF-së dhe stafi shkencor i tyre të jetë koherent me zhvillimet shkencore më të reja në lëmit e ndryshme forenzike në botë, dhe që metodologjitë dhe teknikat e përdorura të jenë në harmoni me standardet ISO17025 duke ditur se ENFSI njihet si një zë i shquar në fushën e Forenzikës në mbarë botën duke siguruar zhvillimin e cilësisë dhe praktikat më të mira në të gjithë Evropën.



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË

Për më shumë informata ju lutem kontaktoni

Web - faqen: www.akf.rks-gov.net

E-mail: agjenciaforenzikes@rks-gov.net

Tel: 00381 (038) 603 - 609 / 610

Tel / Fax: 00381 (038) 603 - 608



Shtypi u financua nga Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve ICITAP